



Mae Brechu yn achub bywydau Vaccination saves lives

A duhet të merrni vaksinën e NHS-it kundër gripit e cila është falas?

Gripi mund të jetë shumë i rëndë, dhe këtë dimër presim të shohim në qarkullim edhe gripin edhe KOVID-19. Marrja e vaksinës kundër gripit çdo vit është njëra ndër mënyrat më të mira të mbrojtjes nga gripi. Kjo është arsyeja përse njerëzit që janë më së shumti të rrezikuar nga një grip i rëndë, nëse infektohen, duhet të marrin vaksinën, edhe nëse ndihen të shëndetshëm.

Vaksina kundër gripit është falas (për njerëzit nga mosha gjashtë muaj) nëse keni:

- problem me zemër
- ankesa në gjoks ose vështirësi në frymëmarrje, përfshirë astmën për të cilën nevojiten rregullisht inhalues steroidesh ose tableta
- sëmundje të veshkëve
- imunitet të zvogëluar për shkak të sëmundjes ose trajtimit (siç është trajtimi me steroide ose për kancer) ose nëse jeni në kontakt të afërt me, ose jetoni në të njëjtën shtëpi me dikë nga ky grup
- sëmundje të mëlçisë
- diabet
- pasur goditje në tru (ose goditje të vogël në tru)
- vështirësi në mësim
- sëmundje neurologjike, siç është skleroza e shumëfishtë (MS), paraliza cerebrale ose sindroma post-polio
- problem me shpretkë, siç është sëmundja e qelizave drapër, ose e keni hequr shpretkën
- peshë trupore të lartë (indeksi i peshës trupore (BMI) më shumë se 40) (dhe jeni më i/e madh/e se 16 vjeç)

Gjithashtu rekomandohet dhe është falas nëse jeni:

- shtatëzënë
- i/e moshës 50 vjeç e më shumë (më 31 mars 2022)
- jetoni në shtëpi pleqsh ose shtëpi për përkujdesje
- kujdestar
- përgjegjës i parë në komunitet (community first responder)
- anëtar i një organizate vullnetare të regjistruar dhe ofroni ndihmë të parë të planifikuar

Kujdestarëve shëndetësor dhe social me kontakt të drejtpërdrejtë me pacientë dhe klientë fuqimisht u rekomandohet të marrin vaksinën kundër gripit. Kjo është për të mbrojtur veten dhe ata për të cilët përkujdesen.

Nëse punoni në një shtëpi për përkujdesje, ose punoni duke u përkujdesur për njerëz në shtëpinë e tyre ju mund të merrni vaksinën falas në barnatoren lokale.

Fëmijë e moshës dy ose tre vjeç (më 31 gusht 2021) duhet të marrin vaksinën kundër gripit në formë të sprejit në hundë. Në shumicën e zonave ata këtë e marrin në klinikën e mjekut të tyre familjar-GP. Të gjithë fëmijë e shkollës fillore dhe gjithashtu asaj të mesme deri në vitin e 11 kanë

Albanian

të drejtë që këtë vit të marrin vaksinën kundër gripit në formë të sprejit në hundë, dhe zakonisht e marrin në shkollë.

Vaksina kundër gripit është njëra nga mënyrat më të mira për t'u mbrojtur kundër infektimit ose shperndarjes së gripit.

Nëse nuk jeni të sigurt nëse mund të merrni falas vaksinën kundër gripit, kërkoni këshilla nga klinika e mjekut tuaj familjar-GP ose nga barnatorja lokale.

Gjeni më shumë informacione lidhur me gripin dhe vaksinat kunder gripit në phw.nhs.wales/flu vaccine